



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 2-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 24.12.2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Safete Amerllahu, anëtare
9. Hyra Bytyqi, anëtar
10. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
11. Sami Bytyqi, anëtar
12. Fitim Shala, anëtar
13. Xhyzide Rustemi, anëtare
14. Rinor Murati, anëtar
15. Armend Grajqevci, anëtar
16. Majlinda Sylejmani, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtar
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragacina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, ish Nënkyetar i Komunës
3. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Merita Bytyqi, DSH
6. Bekim Shabani DEZH
7. Emina Rexhiq DPU
8. Valon Pacolli, DA
9. Anila Reçica, DKRS
10. Nazim Gashi, DE
11. Visar Kozhani, zyrtar i lartë financiar
12. Dhe të tjerë prezent

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së pari i kemi dy zëvendësime të anëtarëve të Kuvendit, ku Elmaze Behluli, nga subjekti LDK, e zëvendëson me Mjalinda Sylejmani, ndërsa Lulzim Qerimin nga subjekti politik PAI, e zëvendëson Enver Kryeziu. Të cilët i lexuan deklaratat e betimit.

Pastaj tha se në mbledhje prezentojnë të gjithë anëtarët e Kuvendit. Rendin e ditës së bashku me material e keni marrë, por kam një propozim që pika e 12-të e rendit të ditës Propozim Venim për zgjedhjen e Komitetit për Komitete, të hiqet nga rendi i ditës pasi që sipas kërkesave që janë ardhë në sektorin e kuvendit janë vetëm të gjinisë mashkullore dhe duhet që të respektohet barazia gjinore. Në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 1-parë e Kuvendit
2. Propozim vendim për plotësimin e vendimit për emërimin e nënkryetarit të komunës për komitete.
3. Raporti i shpenzimeve e të hyrave Janar-Qershor dhe Janar Shtator 2021
4. Raporti i zbatimit të planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit
5. Propozim Statuti i Komunës.
6. Propozim Vendim për miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Komunës (Organogrami).
7. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare konform marrëveshjes për bashkëpunim me IADK.
8. Shqyrtimi i raportit të ZKA-së për PVF 2020.
9. Plani i zbatimit dhe rishikimi periodik i planit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së më 30.09.2021.
10. Raporti vjetor i punës për NJAB për vitin 2020.

11. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
12. Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
13. Propozim vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022.
14. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.

Kryesuesi e vuri ne votim rendit e dites se propozuar me te gjitha votat prezente 31 kaloi redni i dites i propozuar.

Pastaj u vazhdua me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Egzona Bytyqi, tha se ju beë thirje drejtoratit te Shendetesise se bashku me atë te Financave dhe OJQ-të, menaxherët e shkollave qe te bëhet një strategji për eliminimin e dukurive negative siç janë përdorimi i narkotikëve dhe dukuri tjera negative. Me qellim te krijimit te nje ambienti te sigurte për të rinjët dhe per te gjithë komitein pa dallim.

Qështja tjeër kërkoj nga DSHP, të vendosen kamerat e sigurise te shtegu i ecjes ne Lipjan.Po ashtu kam një propozim, për ekipet e vaksinimit të organizohet nje ceremoni dhe te ju ndahen mirënjohje profesionistëve shëndetësorë!

Lumturije Bytyqi-Hasani,tha kam një pyetje per DKA, në shkollën e Shalës mungon profesoresha e gjuhës Angleze për shkak se ka shkuar në pushim të lindjes dhe nga ajo kohë nuk mbahen orët e kësaj lënde.Po ashtu edhe në konkurse nuk është procedura e rekrutimit per atë lëndë në atë shkollë.

Arsim Jashari,tha se do ta ngris një shqetësim për dëmtimin e pronës publike në komunën tonë siç janë objektet e ndryshme parqet, fushat sportive, e të tjera. Rastin e kemi me shkollën fillore “Emin Duraku” Banullë-Glllogovc,ku objekti është demoluar dhe shkatruuar në tërsi dhe deri me sot askush nuk ka dhënë përgjegjësi.Kërkoj nga ana juaj dhe ana jonë si anëtarë te kuevdnit qe ta mbrojmë pronën publike duke bashkpunuar me qytetarët.

Fadil Spahiu,tha se kam dy kërkesa te banorëve të fshatit Smallushë,e para të bëhet bartja e nxënësve të shkollës me transport publik,pasi qe kanë gjatësi dikun 2 klm.Kërkesa e dytë vendosja e mbrojtësve te urave ne fshat pasi qe po rrezikohen qytetarët gjatë kalimit ne ato ura.

Alban Salihu,tha se në javen e kalume kemi pa një protestë të disa fermerëvepërmes mejteve të informimit, A janë takuar ata me dikë nga ekzekutivi si ka mbetur çështja?

Lulzim Rrustemi, tha se kam një pyetje rreth shtrimit te disa rrugicave në fshatin Rufc i Vjetër, a ka ndonjë kriter për shtrimin e atyre rrugëve ose jo?

Shahadije Dragaçina,tha se kam të ngris një shqetësim të banorëve te Lipjanit rreth renovimit te banesave ku ka ankesa nga qytetarët rreth vonimit te punëve ku kanë pritur me muaj per ndërrimin e dritareve te vjetra me ato të rejat, pse ka ndodhur kjo?

Imri Ahmeti, kryetari i komunës, tha e vlerësoj shumë të drejtë kërkesën qe të bëhet një plan i veprimit per dekuritë shqetësuese. Une dakordohem qe te ju bëhet mirënjohje,

por mirënjohjen e kanë nga qytetarët për kontributin e tyre gjatë gjithë kësaj kohe. Sa i përket mësimdhënës në Shalë e drejtë, por neve po na marrin me së paku dy muaj kohë procedurat e konkursit për zëvendësimin e punëtorit të arsimit. Dhe kjo është keq e futur në udhëzimet administrative dhe në si asocion i komunave të Kosovës kemi kërkuar që të ndryshohet kjo. Ju ka ofruar një punëtor të Gadimes të shkojë në atë shkollë, pasi që ka pas me pak orë, por ka refuzuar të shkojë. Sa i përket demtimit të pronës publike shtetëse është vështirë të bëhet gjithkund vendosja e kamerave, të shtegu i biçikletave janë vendosur të shtegu i ecjes dhe ato kamera monitorohen nga policia. Transporti publik është obligim ligjor për nxënësit që e kanë më larg se 4 km shkollën. Idenë e transportit publik unë e kam shty dhe do ta shtyj përpara. Sa i përket urave kur të vihet mundësia buxhetore, ne do ta shohim. Sa i përket banesave ka pas vonës për shkak të kabllove të KEDS dhe kabllove të internetit, si dhe telashe nga disa qytetarë për shkak të ndërimit pa leje. Sa i përket rrugicave në Rrafsh të Rugovës kemi kontratë dy vjeçare dhe do të asfaltohen të gjitha rrugicat në Rrafsh të Rugovës.

Unë i kam takuar dy herë një lloj delegacioni, jam takuar me ta, dhe aty bëhet fjalë për 30 % të dëmeve të shkaktuara gjatë reshjeve, por jo edhe atje ku nuk ka pas vërshime siç është Ribar i Vogël e disa fshatra tjera. Por do të kompensohet të gjithë ata që ka pas vërshime.

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I.

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 1-të të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se unë e kam një vërejtje pasi ka një gabim teknik, unë e kam propozuar për anëtarë të komisionit Fadil Spahiun jo Fadil Sopën.

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 1-të të Kuvendit me vërejtjet e cekura, dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 31 vota për

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 1-të të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim vendim për plotësimin e vendimit për emërimin e nënkryetarit të komunës për komunitete.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Kryetarit të komunës z. Imri Ahmetit, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, në si grup i PDK-së, do të abstenojmë për këtë propozim pasi që qytetarët e komunës së Lipjanit nuk janë nda të kënaqur me punën e tij.

Alban Salihu, ne si grup i LVV-së do të votojmë kundër pasi qe ka qenë edhe mandatin e kaluar nënkryetar dhe gjendja e komunitetit është e randë dhe nuk është vërejt ndonjë ndryshim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për,6 kundër dhe 7 apstenime aprovoi:

Shtesë: Vendimi.

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE

Neni 1

Emërimi

Lulzim Qerimi nga Magura me përgaditje profesionale superiore – drejtimi administratë publike nga komuniteti jo shumicë ashkali, **emërohet** Nënkyetar i Komunës për Komunitete në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Përgjegjësitë

1. Nënkyetari i Komunës për Komunitete e ndihmon Kryetarin në kryerjen e detyrave të tij,
2. Ofron këshilla dhe udhëzime lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo shumicë,
3. Mbështet dhe afirmon kërkesat e komuniteteve jo shumicë në organet e Komunës.

Neni 3

Mandati

Mandati i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete është i njëjtë me atë Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

III.

Raporti i shpenzimeve e të hyrave Janar-Qershor dhe Janar Shtator 2021

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, këtu kemi të bëjmë me dy raporte atë 6 mujor dhe 9 mujor, dhe kjo është neglizhencë e ekzekutivit, dhe është dashtë të vie me herët. Një buxhet i shpenzuar jo mirë dhe ka mjete ende të mbetura dhe kjo shihet që ka menaxhim të dobët. Po ashtu edhe të investimet kapitale kemi të shpenzuar shumë pak. Edhe të granti qeveritar kemi buxhet të shpenzuar jo të mire. Të investimet kapitale kemi shpenzim të dobët. Edhe të buxheti me donatore kemi buxhet jo të shpenzuar mire. Edhe të qeraja e bojkoteve kemi të dyra shumë të vogla. Në përgjithësi kemi raport të shpenzimeve të dobët dhe preim që raporti vjetor të ketë përmirësime në shpenzime buxhetore dhe të plotësojë nevojat e qytatrëve. Kërkoj një sqarim të përfituesit individual kush kanë qenë, si dhe të shpenzimet kontraktuale me na tregu cilat janë.

Besiana Syla, tha se komuna Lipjanit ka shpenzuar në mënyrë të kënaqshme buxhetin. Në shpenzim të tërësishëm të buxhetit kemi një rritje me krahasim me vitin e kaluar. Po ashtu të qeraja e objekteve kemi pas një shumë të vogël të mjeteve të inkasuara. Nëse e bojmë krahasimin me vitin paraprak kemi rritje të hyrave po kjo ndoshta për shkak se ka qenë vit i pandemisë.

Lumuriye Bytyqi-Hasani, deshta mu ndal të lista e lëndëve të egzekutura nga thesari, është mirë që këto të parashihet në buxhet, si pagat jubilarë ashtu edhe pagat dhe me rastin e pensionimit. Ka ardhë koha që kjo të jetë lista e fundit që po e demtohet komuna e Lipjanit ku duhet këto mjete të planifikohen.

Latif Ramadani, është një raport real që ka ndodhë, dhe kemi një përqindje të kënaqshme të shpenzimit. Qerata, inkasimi është bërë për ato lokale që janë dhënë në shfrytëzim. Shërbimet tjera kontraktuese janë, mirëmbajtja e komunës, parqeve, sigurimi i komunës dhe të tjera të ngjashme me to.

Pastaj u kalua në pikën tjetër në vazhdim.

III.

Raporti i zbatimit të planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Valon Pacolli, drejtor i DA-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se u bënë një vit nga miratimi i planit të integritetit, nga ajo që e pamë kemi një raport jo shumë të kënaqshëm. Shpresojmë që ky plan në të

ardhmen te aprovohet dhe te permsirsohen mekanizmat ku janë prekë dhe te evitohen rreziqet.

Besiana Sylaj, i kam 3 pyetje, cilat kanë qenë kriteret në peracktimin e faktorëve të rrezikut? Cka ka ndërmarrë komunë për faktorët e rrezikut të pazbatueshëm? A ekziston një monitorim i jashtëm për faktorët e rrezikut?

Majlinda Sylejmani, planin e integritetit e kemi votuar mandatin e kaluar, komuna e lipjanit ka pas hapësire të miftushme për me dhënë komente dhe sugjerime gjate hartimit te këtij plani. Po me vjen mirë qe janë paraqitur ne raport te gjitha reziqet si dhe masat ekzistuese. E kemi nje progres ne raport me pritshmerite. Ne si grup i LDK-së i ofrojmë mbështetje.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, ky raport ka një progres, dhe saktësisht siç e keni te shkruar e keni ne praktike, na duhet ende punë. Qeshjet qe u ngriten janë ne raport te gjitha.

V.

Propozim Statuti i Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Fauz Xhemajlit nënkryetar i komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Statuti.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne si grup i PDK-së, përtej dallimeve politike dhe partiake, si gjithmonë do të përkrah projektet të cilat janë në të mirë të përgjithshme, që i kontribuojnë zhvillimit të përgjithshëm të komunës së Lipjanit, si dhe ngritjes së cilësisë së qeverisjes komunale. PDK, është pozicionuar qartë për qëndrim në opozitë në përputhje me vullnetin qytetarë, dhe ju garanton qytetarëve të Lipjanit, se do të jetë gardiane e interesit qytetarë, zë kritik dhe konstruktiv opozitar, duke përkrahur qeverisjen komunale në projektet kapitale të komunës, si dhe duke e kritikuar për fenomenet të cilat duhet të kritikohen. Ne do jemi aty për të mbrojtur interesat e qytetarëve, si grup i PDK-së do ta përkrahim këtë propozim.

Mjalinda Sylejamni, ne si grup i LDK-së e kemi shqyrtuar këtë propozim vendim të statutit, dhe menjëherë qe ky ndryshim është i nevojshëm dhe si të tillë e përkrahim.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës, tha se esenca e këtij ndryshimi është qe të harmonizohet me legjislacionin qe është në fuqi. Dhe ne kemi pas ne statut fshatra qe nuk jane në teritorin tonë. Ne fshatrat nuk kemi mujt me i ndryshu, pasi qe kemi fshatra ne statut te cilat nuk ekzistojnë, siç janë, Lipovica, Shisharka e tjera, ose kemi fshatra qe nuk i kemi prap ne statut siç janë Jeta e Re, Rubofci i Vogël. Dhe na do të bëjmë kërkesë për këto fshatra.

Drejtorati për mbrojtje dhe Shpëtim ka pas mbet si keq, ndërsa tani e kemi zgjeru, Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim dhe do të keni do punë më shumë. Kë ndryshim po bëhet në të mirën e qytetarëve.

Lulzim Rrustemi, tha se te Statuti i komunës dhe te Ligji për kufijte ka shpërputhje të mëdha, dhe kisha propozu që prej këtij kuvendi me lindë ideja për rindryshim te ligjit,

pasi qe ne ligj mungojnë disa fshatra siç janë Qellapeku, Gllavica tjera. Sa i perket ndryshimeve te drejtoratet është një ndryshim bukur logjik.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës, tha na do ta perserisim kërkesën per harmonizim te ligjit me stautin, po ne ligj permenden zonat kadastrale jo fshatrat. Une dakordohem qe te kërkojmë harmonizimin e ligjit me fshatrat te cilat i kemi.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e Statutit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 6 kundër dhe 1 apstenim aprovoi Statutin

Shtesë:Statuti.

VI.

Propozim Vendim për miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Komunës (Organogrami).

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, nënkryetarit të komunës Fauz Xhemajlit, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Besiana Syla, tha kam pyetje, kjo strukturë është e mbuluar me buxhet, sa është ndryshimi në mes të strukturës së kaluar dhe kësaj strukturës së re.

Arsim Jashari, tha se ne si grup i PDK-së, kërkojmë te respektohet meritokracia, dhe mos të bëhen anime politike.

Imri Ahemti kryetari i komunës tha, se organogrami është në përputhje me nevojën e rifreskimit dhe riorganizimit të disa drejtorate dhe ka shtim te stafit ne disa drejtorate dhe shkurtim ne disa drejtorate. Do të shtohen disa sektor siç është ai i rinisë. Koeficientet jan rritur per te gjithë, me përjashtim te dy rasteve të cilat janë te cekura në arsyetim. Ky organogram do te implemetohet ka mesi i vitit të ardhshëm. Të gjithë shërbyesit civilë për mu janë të barabartë.

Une po e bëj një njoftim qe nënkryetari im i ri do të jetë Diamant Bytyqi.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se Diamantit i urojmë suksese ne emër timin dhe në emër të anëtarëve të kuvendit. Dhe e falënderoj kryetarit qe po ju ep hapësirë gjeneratave të reja.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, 5 kundër aprovoi venimin:

Shtesë:Vendimi

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS (ORGANOGRAMIT)

- I. MIRATOHET , Struktura Organizative e Administratës së Komunës (Organogramit).
- II. Qëllimi i miratimit të këtij Vendimi është përcaktimi i organizimit dhe funksionimit të organeve të Administratës së Komunës.
- III. Administrata e Komunës është e riorganizuar në Zyrën e Kryetarit të Komunës, Drejtorate, Sektor, Zyra dhe Njësi të tjera organizative.
- IV. Struktura Organizative e Administratës së Komunës përcakton: Emërtimin e pozitave të përcaktuar sipas Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Shërbimin Civil dhe përfshin:
- Përgatitjen profesionale,
 - Numrin e kryersve,
 - Koeficientin .
- V. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e ardhëshme në Strukturën Organizative të Administratës së Komunës kalojnë në përgjegjësinë dhe kompetencën e Kryetarit të Komunës i cili sipas nevojës themelon ekipin profesional komunal, konform legjislacionit në fuqi dhe nxjerr Vendim për strukturën e re organizative të Administratës Komunale.
- VI. Koeficientët ose gradat do të harmonizohen në vazhdimësi me Ligjin e pagave dhe dispozitat tjera përkatëse ligjore.
- VII.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Zyra e Kryetarit të Komunës -Sektori për Personel.
- VIII.Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Struktura organizative e Administratës së Komunës (Organogrami), në formë tabelare.
- IX. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në webfaqen e Komunës.
- Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet :
1. Vendimi për nxjerrjen e Strukturës Organizative të Administratës së Komunës INr.020-319 i datës 31.03.2010
 - . Vendimi për Strukturën Organizative të Administratës së Komunës Nr.1-112-14940 të datës 12.03.2018.

Pastaj Daut Azemi, kryesues i Kuvendit dha pauzë nga ora 11:50 deri në ora 13:30

VII.

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare konform marrëveshjes për bashkëpunim me IADK.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, I cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, na e mbështesim, mbështetjen e bujqëve, por a ka mundësi me ditë kush ka qenë në këtë komision.

Egzona Bytyqi, tha e përgëzoj kryetarin për këtë vendim të cilin e ka marr për Diamantin, dhe është nder dhe privilegj për neve fshatin Qylagë që e kemi nënkryetar shokun tim të klasës të cilin i uroj shëndet dhe suksese.

Sa i përket propozim vendimit ne si grup i PDK-së e kemi shqyrtu dhe e përkrahim në mënyrë unanime këtë propozim.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, se mbi 2 mijë euro është përgjegjësi e asamablesë ndërsa deri në 2 mijë e drejtë e kryetarit. Komisioni është caktuar nga IADK-ja në bashkëpunim me komunën

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi këtë vendim.

Shtesë:Vendimi

V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **14,690.00 €** (katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë euro), për kryerjen e obligimeve që rrjedhin konform dispozitave të Marrëveshjes trevjëqare për Bashkëpunim që përfshin periodën kohore 2020-2022 të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës- IADK 1Nr.320-16457 të datës 18.03.2020 për zbatimin e Projektit **“Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës** i financuar nga Donatori BfdW nga Gjermania dhe zbatuar nga IADK që shtrihet në komunat Vushtrri, Skenderaj, **Lipjan**, Shtime, Viti dhe Kamenicë.

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet konform dispozitave të nenit 3 të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK, 1Nr. 320-16457 të datës 18.03.2020 në të cilën përcaktohet që Komuna e Lipjanit do të participojë me 20% të bashkëfinancimit për përfituesit e përzgjedhur dhe mbështetur duke u bazuar në Kërkesën e IADK-së me numër 12-320-55638 për bashkëfinancim të projektit të parashtruar me datë 15.09.2021 lidhur me aktivitetet e realizuara në ngritjen e kapaciteteve profesionale të fermerëve në sektorin e pemëve dhe perimeve dhe përkrahjen direkte me grante për 9 fermer në Komunën e Lipjanit ku Komuna e Lipjanit obligohet të bashkëfinancoj me mjete financiare në vlerë prej 7,020.00 € dhe Kërkesën e parashtruar poashtu

nga IADK me numër 12-320-60319 e datës 30.09.2021 lidhur me aktivitetet e zhvilluara në ngritjen e kapaciteteve profesionale të rinjëve në sektorin e bujqësisë dhe menaxhimit të biznesit si dhe përkrahjen direkte me grante për 9 fermer të rinjë dhe poashtu përkrahja e grave me trajnime profesionale për përpunim të qumështit dhe përpunim të pemëve dhe perimeve në vlerë prej 7,670.00 ku vlera e përbashkët për këto projekte përfshin shumën prej 14,690.00 € (katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë euro), të cekur në pikën I të këtij Vendimi.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës-kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për Drejtoratin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

VIII.

Shqyrtimi i raportit të ZKA-së për PVF 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Safet Krasniqit Auditor i mbrenshëm, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Besiana Sylja, tha se ZKA paraqet raport të pa modifikuar për pasqyrat financiare të vitit 2020 që dmth pasqyrat paraqesin një pamje të drejtë në të gjitha aspektet. Por kemi mundësi të bëhet shpenzimi sa më racional i parasë publike. Në bazë të pasqyrave financiare komuna e Lipjanit ka suficit një shumë të mjeteve. Disa rekomandime nga auditori nuk janë adresuar, dhe nuk e di kryetari a ka marrë ndonjë aktivitet lidhur me këto rekomandime

Lulzim Rrustemi, tha se i përket ZKA, kualifikimi i pa modifikuar një kualifikim i mirë, por ka disa gjetje siç është vendimi i qeverisë, po ashtu edhe pagesat që kanë qenë dikur tjetër dhe janë destinuar diku tjetër dhe kjo është një gjetje koxha e rëndësishme. Në bazë të vendimit të qeverisë komunat e Kosovës janë shpërblye me 10 milion euro, dhe ju këto rekomandime vet i keni pranuar. Po ashtu kemi edhe disa rekomandime për aktivitete jashtë planit të prokurimit. Po ashtu dobësi në procesin e prokurimit. Te klubet sportive mungoj faurat të Ulpiana dhe Arbëria. Si dhe kryerja e disa punëve me vonesa. Dhe ka mundësi për përmirësime ende.

Imri Ahmeti, kryetari i komunës tha, komuna e Lipjanit është viti i 5 –të që e merr opinionin i pa modifikuar, dhe ne kemi nevojë për ndryshime se nuk jemi të gabueshëm por mos harroni që ka qenë vit që jemi përballë me pandeminë dhe kemi punuar me staf të reduktuar. Në vitin e kaluar kemi fal disa borxhe, si për çerdhe, dhe për disa kategori tjera. Ne si ekzekutiv kemi defekte por jemi vlerësuar me dontën me të lartë, dhe kemi fituar disa projekte fal punën së mirë. Dhe ne do të prevojme ti modifikojmë rekomandimet.

Plani i zbatimit dhe rishikimi periodik i planit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së më 30.09.2021

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Safet Krasniqi, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga plani.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, a keni bërë kërkesë në ministrinë për financave për fshirjen e këtij borxhi.

Safet Krasniqi, po e kemi shqyrtu këtë çështje me drejtorin për ekonomi dhe zhvillim, e kemi përcjell shkresën në zyren ligjore.

X.

Raporti vjetor i punës për NJAB për vitin 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Safet Krasniqi, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti dhe plani i veprimit

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha deshta me pyet se kush janë anëtar të komitetit të auditimit pse nuk janë publikuar në raport.

Safet Krasniqi, janë dy udhëzime administrative për themelimin e komiteteve të auditimit dhe kompetencë ju ka lenë ministrave në nivel qendror apo në nivel lokal kryetarëve të komunave

XI.

Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Gazmend Qerkini tha se në si grup i LDK-së për anëtarë të KPF-së i propozojmë:

Daut Azemi, - Kryesues

Hyra Bytyçi,

Xhyla Dedushaj-Rexhepi,

Fitim Shala,

Lulzim Rrustemi, tha se në si grup i PDK-së për anëtarë të KPF-së i propozojmë:

Arsim Jashari,

Egzona Bytyqi,

Shahadije Dragaçina, tha se në si grup i LVV-së për anëtar të KPF-së propozojmë

Alban Salihun

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 31 vota për, aprovoi

Shtesë:Vendimi

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Kryesuesi i Kuvendit është Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 3

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mandat 4 vjeçar

Neni 4

Për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa emërohen si vijon:

1. Daut Azemi, subjekti politik-LDK- Kryesues
2. Hyra Bytyçi, subjekti politik- LDK, anëtare
3. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, subjekti politik- LDK anëtare
4. Fitim Shala, subjekti politik- LDK anëtar
5. Arsim Jashari, subjekti politik- PDK anëtar
6. Egzona Bytyqi, subjekti politik- PDK anëtare
7. Alban Salihu, subjekti politik- LVV anëtar

Neni 5

Komiteti për politikë dhe financa në pajtim me dispozitat e nenit 52 par.52.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

XII.

Propozim vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani,se pari i uroj suksese Diamantit ne detyren e re, pasi qe është një njeri shumë i sjellshëm, por po më pengon qe nuk ka femra ne pozitat kyçe, dhe te pakten shpresojme qe ne ekzekutiv te ketë femra me shumë.

Ndërsa sa i përket rendit të ditës është mirë qe të përfshihet në muajin dhjetor, raportimi i komiteteve obligative para kuvendit në planin e punës.

Lulzim Rrustemi, është mirë qe te jetë një informatë e shkurtër rreth pandemisë nga drejtorati i shëndetësisë në planin e punës.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi

Shtesë: Vendimi.

XIII.

Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi,ia dha fjalën Elmaze Behlulit DKA e cila i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani,kam një kërkesë qe të respektohet barazia ligjore, qe te jetë një derjtoreshë në komision.

Alban Salihu, tha edhe une propozoj qe te ndërrohet anëtari i dytë i komisionit per shkak të barazisë ligjore, dhe nuk është kredibil.

Lulzim Rrustemi,une pajtohna me dy parafolësit,pasi qe ka drejtor ma kredibil, Astriti është përfshi kapak në politikë, dhe te jetë një drejtoreshë në komision më mirë.

Imri Ahmeti kryetari i komunës tha,është obligim qe te votohet 1 herë në vit ky komision në kuvend.Unë në vend të Astrit Buja e propozoj Drita Islamin

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi

Shtesë: Vendimi

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT ORIENTUES TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2022

Neni 1

MIRATOHET Plani orientues i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

Neni 2

Kuvendi i Komunës së Lipjanit planifikon ti mbajë 12 mbledhje të rregullta dhe secilës mbledhje të rregullt i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 3

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen sipas periodës kohore me rendin e ditës sipas tabelës në vijim:

JANAR 2022	Informatë e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2022
	Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare të Komunës për periudhën Korrik – Dhjetor 2021
	Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë nga Drejtorati për Shëndetësi rreth pandemisë
SHKURT 2022	Bartja (rialokimi) i buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak
	Informatë mbi përfundimin e gjysmëvjetorit të parë shkollor
MARS 2022	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës për vitin 2021
PRILL 2022	Shqyrtimi i informatës tremujore financiare të Komunës për periudhën Janar – Mars 2022
	Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
Maj 2022	Informatë mbi Qarkoren e pare buxhetorete MF-se
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi punën e komiteteve funksionale
QERSHOR 2022	Miratimi i Korrnizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025
	Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2022
	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi realizimin e Planit të Prokurimit
KORRIK 2022	Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës për periudhën Mars – Qershor 2022
	Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2020
	Informatë mbi Raportin e Performancës
	Informatë mbi përfundimin e vitit shkollor
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
GUSHT 2022	Informatë mbi përfundimin e fushatës së korrje-shirjeve
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi Qarkoren e dytë buxhetore të MF-se
SHTATOR 2022	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2023
	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023
	Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë
	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa komunale
TETOR 2022	Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës për periudhën Korrik – Shtator 2022
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
22	Informatë e Drejtoratit për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale për ofrimin e shërbimeve

Neni 4

4.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave tjera ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit mban së paku dhjetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.2 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.3 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne në rastet e caktuara me dispozitat e cekura ligjore.

Neni 5

Plani i mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në nenin 3 të këtij Vendimi është orientues dhe do të mund të ketë ndryshime gjatë vitit.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14,⁵⁵

Ekstraktin e hartoi
Zyrtari Ligjor
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi